Mekanizmat komunalë të pjesëmarrjes së komuniteteve, përkatësisht Komitetet për Komunitete (KpK), Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), Nënkyetarët e Komunave për Komunitete (NKKKK) dhe Zëvendëskryesuesit e Kuvendeve Komunale për Komunitete (ZKKKK), janë faktorë kryesorë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve (në pakicë numerike në nivel lokal). Në zbatimin e mandateve të tyre të dalluara, por të ndërlidhura, këta mekanizma mbulojnë një gamë të gjerë fushash ndërhyrjeje, nga këshillat për udhëheqësit komunalë dhe pjesëmarrja në vendimmarrje, deri tek angazhimi i drejtpërdrejtë me komunitetet me qëllim të, mes tjerash, monitorimit të nevojave dhe shqetësimeve të tyre, zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të ndihmës, por edhe promovimit të dialogut ndërmjet komuniteteve. Megjithatë, ndërsa disa mekanizma të pjesëmarrjes së komuniteteve arrijnë standarde të larta në ofrimin e shërbimeve të tyre, të tjerët kanë mbetur prapa.

Kjo Përmbledhje synon t'ju ofrojë mekanizmave të pjesëmarrjes së komuniteteve udhëzime për të rritur performancën në mandatet e tyre përkatëse, e në veçanti, në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve specifike dhe detyrave thelbësore. Në shërbim të këtij qëllimi, kjo përmbledhje praktikash fokusohet në intervenimet, mësimet e nxjerra dhe historitë e suksesit që janë njohur si praktika të mira, si dhe mund të shkëmbehet suksesshëm nëpër komuna për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të tyre cilësore, me synimin për të nxitur edhe bashkëpunimin ndër-komunal.

## Metodologjia

Informatat mbi praktikën janë mbledhur përmes monitorimit të rregullt dhe intervistave me përfaqësues nga secili mekanizëm, si dhe në konsultim me palët tjera kryesore të interesit gjatë vitit 2021. Meqenëse secili mekanizëm kryen një sërë aktivitetsh dhe detyrash thelbësore në disa sektorë të ndryshëm, Përmbledhja përqendrohet në aktivitetet dhe detyrat themelore në kryerjen e të cilave, janë shënuar praktika të mira gjatë një periudhe katërvjeçare, 2017-2021. Pas raundit fillestar të konsultimeve, janë identifikuar më shumë se 70 praktika. Më pas, praktikën e zgjedhura janë renditur në një listë të ngushtë sipas relevancës, ndikimit, shtrirjes së tyre nëpër komuna, si dhe për të siguruar, në masën më të madhe të mundshme, përfaqësim të barabartë gjeografik të mekanizmave. Përmbledhja është ndarë në katër kapituj, ku secili i kushtohet njërit prej mekanizmave të lartpërmendur të pjesëmarrjes së komuniteteve. Në fillim të secilit kapitull, hyrja e shkurtër ofron informata bazike mbi mandatin, përbërjen dhe kornizën rregullative të secilit mekanizëm. Më pas, paraqiten praktikën e zgjedhura, në përputhje me detyrat e ndryshme thelbësore të mekanizmave të ndryshëm, bashkë me bazën e tyre ligjore përkatëse.

## Komiteti për Komunitete

Komitetet për Komunitete (KpK) janë mekanizma komunalë obligative, të përbërë nga këshilltarët e Kuvendit Komunal (KK), si dhe të paktën një përfaqësues të çdo komuniteti që banon në komunë. Përfaqësuesit e komuniteteve duhet të përbëjnë shumicën e anëtarëve të KpK-së. Kompetenca kryesore e KpK-së është (i) t'i shqyrtojë të gjitha politikat, praktikat dhe aktivitetet komunale për të siguruar që të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve respektohen plotësisht, (ii) t'i bëjë rekomandime Kuvendit për sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit adekuat të të drejtave dhe interesave të komuniteteve brenda komunës, si dhe (iii) të koordinojë dhe bashkëpunojë me mekanizmat e tjerë për mbrojtjen e komuniteteve.

Dokumentet kryesore ligjore dhe politikat për krijimin dhe funksionimin e KpK-ve janë:

- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040;
- Udhëzimi Administrativ (UA) i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) Nr. 02/2018 mbi Procedurën e Themelimit, Përbërjes dhe Kompetencave të Komiteteve të Përhershme në Komunë; i ndryshuar me UA MAPL Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencave të komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë;
- Udhëzimet e MAPL-së për Komitetet për Komunitete;
- Termat e Referencës së MAPL-së për Komitetet për Komunitete.

## Praktikat e Zgjedhura

Funksionet substanciale	<b>Ofrimi i rekomandimeve për sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit adekuat të të drejtave dhe interesave të komuniteteve</b>
Baza ligjore	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 53.2; Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2020, Neni 7.1.2; Udhëzues për KpK-të, neni 4.1; Termat e Referencës të KpK-të, neni 5;



<p>Praktikat e zgjedhura</p>	<p><b>KpK-ja në Pejë bën rekomandime në mënyrë proaktive për organet komunale për adresimin e çështjeve që lidhen me komunitetet.</b></p> <p>Në komunën e Pejës, KpK-ja ka identifikuar nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve jo-shumicë gjatë vizitave në terren dhe në takimet e tij të rregullta. Bazuar në vlerësimin e tij, KpK-ja ka hartuar rekomandime për adresim tek drejtoritë komunale, kryetari i komunës, apo organet tjera. Rekomandimet kishin të bënin me çështje dhe nevoja të komuniteteve që banojnë në komunë, siç janë çështjet kadastrale, menaxhimi i mbeturinave dhe projektet e infrastrukturës në fshatrat dhe lagjet e banuara kryesisht nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe boshnjak të Kosovës. Si rezultat i kësaj, në shumë raste komuna ka ndërmarrë veprime si dhe ka adresuar nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve jo shumicë.</p>
<p>Funksionet substanciale</p>	<p><b>Avokimi për financimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrja në procesin e përgatitjes së buxhetit</b></p>
<p>Baza ligjore</p>	<p>Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 53.2; Udhëzuesi për KpK-të, neni 4.4; Termat e referencës së KpK-ve, neni 5.2.4;</p>
<p>Praktikat e zgjedhura</p>	<p><b>KpK në Pejë avokon tek organet komunale për financimin e aktiviteteve dhe projekteve në mbështetje të komuniteteve jo-shumicë.</b></p> <p>Në komunën e Pejës, KpK-ja ka avokuar tek organet komunale që të ndahen fonde komunale për financimin e aktiviteteve dhe projekteve në mbështetje të komuniteteve jo-shumicë. Si rezultat, Kuvendi Komunal (KK) dhe drejtoritë përgjegjëse komunale iu përgjigjën kërkesës së KpK-së dhe financuan disa projekte, duke përfshirë rinovimin e shkollës së mesme të mjekësisë dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, siç është ajo në lagjen “7 Shtatori” në Pejë. Në shumë raste, avokimi i KpK-së ka kontribuar në zgjidhjen e çështjeve të vjetra që kanë ndikuar tek komunitetet.</p> <p><b>KpK në Fushë Kosovë avokon për projekte infrastrukturore me rëndësi për komunitetet.</b></p> <p>Në Fushë Kosovë, KpK-ja u informua për nevojën për punime në infrastrukturën rrugore në një zonë të banuar kryesisht nga komuniteti serb dhe komuniteti rom të Kosovës. Infrastruktura funksionale rrugore ka rëndësi jetike për komunitetet në pakicë numerike, sidomos për ato që banojnë në zonat rurale dhe të largëta, sepse mundëson qasje në kujdesin shëndetësor, arsim, shërbime publike dhe punësim. Prandaj, KpK është angazhuar në avokim me Zyrën e Kryetarit të</p>

Komunës dhe drejtues të tjerë të rëndësishëm komunalë për të adresuar çështjen e identifikuar. Konkretisht, në koordinim të ngushtë me ZKKK, KpK i dorëzoi një propozim projekt Kryetarit të Komunës për mirëmbajtjen e infrastrukturës publike. Projekti u miratua nga Kryetari i Komunës dhe u ndanë fonde që të mund të zbatohet në mënyrë të shpejtë. Financimi u bë në kuadër të linjës së investimeve kapitale të buxhetit komunal, e më pas u aprovua nga Kuvendi. Ndërhyrja e KpK-së mundësoi që të trajtohet shpejt nevoja e identifikuar, si dhe krijoi kushte për qasje që mbulon tërë komunën. Zbatimi i projektit të infrastrukturës solli përfitime afatgjata për komunitetet që jetojnë në zonën në fjalë, sidomos në aspektin e qasjes në shërbime dhe transport.

**KpK-ja në Leposaviq është aktiv në përgatitjen e buxhetit komunal, duke paraqitur propozim-projekte që shkojnë në dobi të komuniteteve jo-shumicë.**

Në Leposaviq, KpK-ja ka diskutuar dhe përzgjedhur projekt-propozime për të adresuar nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve në pakicë numerike. Në veçanti, Kryetari i KpK-së kërkoi nga anëtarët e KpK-së të identifikojnë projekte që u përgjigjen nevojave të komuniteteve të tyre përkatëse dhe, për ta bërë këtë, ata kishin në dispozicion dy (2) muaj kohë. Më pas, lista përfundimtare e projekteve u miratua dhe iu dorëzua Kuvendit të Komunës për diskutim mbi përfshirjen e tyre në buxhetin komunal. Këto projekte përfshinin asfaltimin e një rruge lokale, ndërtimin e një sistemi kanalizimesh, si dhe një shesh lojërash për fëmijë në zonat e banuara nga komunitetet në pakicë numerike. Bashkëpunimi me Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Njësinë Mbështetëse të Kuvendit, si dhe zyrtarë të tjerë komunalë kompetentë për çështjet e komuniteteve dhe kthimit, është faktor kyç për ushtrimin e plotë të rolit të KpK-së në këtë sektor, por edhe për të siguruar qëndrueshmërinë e praktikës. Angazhimi i vazhdueshëm i KpK-ve në përgatitjen e buxhetit komunal ka dhënë rezultate të drejtpërdrejta në drejtim të adresimit të nevojave dhe interesave të komuniteteve, si dhe e ka kthyer KpK-në në një faktor kryesor në procesin e përgatitjes së buxhetit.

Funksionet  
substanciale

**Planifikimi i ndërhyrjeve përmes vlerësimit të nevojave dhe/ose konsultimit të drejtpërdrejtë me komunitetet**

Baza ligjore

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 53.2; Termat e referencës së KpK-ve, neni 5.2.9;

<p>Praktikat e zgjedhura</p>	<p><b>KpK-ja e Prizrenit kryen vizita në terren tek komunitetet jo-shumicë për të ngritur vetëdijen mbi përgjegjësitë e mekanizmave të pjesëmarrjes së komuniteteve dhe aktivitetet e tyre specifike.</b></p> <p>Në Prizren, KpK-ja ka identifikuar mungesën e vetëdijesimit tek pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë mbi rolin e mekanizmave të pjesëmarrjes së komuniteteve, përkatësisht KpK, ZKKK, NKKK dhe ZKKKK. Kjo është vërejtur sidomos në zonat rurale, të banuara kryesisht nga komuniteti boshnjak dhe komuniteti serb të Kosovës. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e ZKKK-së, NKKK-së dhe OSBE-së, KpK-ja organizoi vizita në terren në një zonë të banuar nga disa komunitete për të ngritur vetëdijesimin në mesin e tyre për përgjegjësitë e mekanizmave të pjesëmarrjes së komuniteteve, si dhe për aktivitetet specifike që ato ndërmarrin. Gjatë këtyre vizitave, takimet me pjesëtarët e komuniteteve u mbajtën në mjediset e shkollave në fshatrat e vizituar, ku përfaqësuesit e mekanizmave të pjesëmarrjes së komuniteteve prezantuan mandatet dhe planet e tyre të punës. Për më tepër, këto vizita kanë krijuar mundësi për pjesëtarët e komunitetit që të diskutojnë nevojat dhe interesat e tyre, si dhe për të sjellë çështjet shqetësuese drejtpërdrejt në vëmendjen e zyrtarëve komunalë. Këto çështje u renditën në një listë të prioriteteve dhe shqetësimeve që iu dorëzuan përfaqësuesve ekzekutivë të komunës për shqyrtimin dhe veprimin e tyre brenda kornizës buxhetore afatmesme dhe vjetore komunale.</p>
<p>Funksionet substanciale</p>	<p><b>Përgatitja e raportit të shkruar vjetor</b></p>
<p>Baza ligjore</p>	<p>Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2020, Neni 10.5; Udhëzuesi për KpK-të, Neni 5.1 dhe Shtojca C; Termat e Referencës të KpK-së, neni 7;</p>
<p>Praktikat e zgjedhura</p>	<p><b>Kryesuesi i KpK-së në Mitrovicën e veriut udhëheq në përgatitjen e raportit vjetor të KpK-së në mënyrë proaktive dhe gjithëpërfshirëse.</b></p> <p>Në Mitrovicën e veriut, kryesuesi i KpK-së ka pasur rol proaktiv në përgatitjen e raportit vjetor. Në veçanti, pas përgatitjes së draftit të parë të raportit, Kryesuesi e ndau atë me anëtarët e KpK-së në kopje elektronike për shqyrtimin dhe reagimet e tyre, si dhe e përktheu draftin e raportit në të dy gjuhët zyrtare, para se të caktonte mbledhjen e KpK-së për shqyrtimin e tij. Gjatë mbledhjes, drafti i raportit dhe komentet e anëtarëve të KpK-së u diskutuan, ndërsa versioni përfundimtar i raportit vjetor u miratua dhe u shpërnda tek anëtarët e KpK-së dhe të Kuvendit Komunal, Kryesuesi i KK-së, ZKKKK-ja dhe Zyra e Kryetarit të Komunës, si dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Gjithashtu, në dispozicion janë vënë edhe kopjet elektronike të raportit. Dokumenti përfshin kapitujt vijues: (i) prezantimi i KpK-së si mekanizëm i mbrojtjes së komuniteteve dhe komitet</p>

obligativ i Kuvendit, (ii) përmbledhje e aktiviteteve kryesore të KpK-së dhe sfidat me të cilat përballet mekanizmi gjatë periudhës raportuese, (iii) çështjet dhe shqetësimet kryesore të komuniteteve që lindin, ose kanë vazhduar dhe (iv) rekomandimet për të adresuar këto çështje. Raporti po ashtu ka një faqe me shkurtesat e të gjitha institucioneve vendore dhe qendrore, si dhe organizatave ndërkombëtare aktive në rajon, si dhe ka format lehtësisht të kuptueshëm për përdoruesit. Raportimi efektiv dhe me kohë, në pajtim me kornizën ligjore dhe të politikave, siguron që Kuvendi dhe Zyra e Kryetarit të Komunës të informohen në mënyrë adekuate për aktivitetet e KpK-së, si dhe të angazhohen më shumë në to.

**KpK në Malishevë rregullisht përgatit plane dhe raporte vjetore të punës, nën udhëheqjen e kryesuesit të tij.**

Në Malishevë, në koordinim me anëtarët e KpK-së, si dhe me mbështetjen e ZKKK-së dhe ekipit në terren të OSBE-së, Kryesuesi i KpK-së ka përgatitur rregullisht planet dhe raportet vjetore të punës së KpK-së. Gjatë periudhës 2018-2020, Kryesuesi i KpK-së është siguruar që këto dokumente të shqyrtohen e miratohen nga KpK-ja, e më pas t'i paraqiten Kuvendit për miratim dhe përfshirje në planet e punës së Kuvendit Komunal. Plani i punës përfshin, ndër të tjera, aktivitetet e mëposhtme: (i) bashkëpunimin e rregullt me ZKKK-në; (ii) vizita në terren në zonat e banuara kryesisht nga komunitete jo-shumicë; (iii) shqyrtimin e raporteve nga drejtoritë komunale; dhe (iv) avokim me drejtoritë përkatëse komunale për ndihmë ndaj komuniteteve jo-shumicë, bazuar në rekomandimet e mëparshme të KpK-së. Planifikimi i rregullt dhe me kohë i aktiviteteve, si dhe raportimi mbi ato aktivitete, është kthyer në një praktikë të qëndrueshme, që i mundësuar KpK-së në Malishevë të ketë program gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të ndërhyrjeve, si dhe bashkëpunim më të mirë me drejtoritë komunale, të cilat gjithashtu kanë marrë pjesë në takimet e KpK-së.

Funksionet substanciale	<b>Kontaktet dhe angazhimi i jashtëm me komunitetet</b>
Baza ligjore	Termet e Referencës të KpK-ve, neni 5.2.8;
Praktikat e zgjedhura	<b>KpK-ja në Viti angazhohet drejtpërdrejt me komunitetet jo-shumicë përmes konsultimeve të drejtpërdrejta dhe aktiviteteve në terren.</b>  Në Viti, KpK-ja zhvillonte vizitë kontaktuese çdo katër muaj tek komunitetet jo-shumicë që banojnë në komunë. Gjatë një vizite kontaktuese në terren në fshatin Letnicë, ku banorët janë të komunitetit kroat dhe komunitetit shqiptar të Kosovës, anëtarët e KpK-së u takuan me kroatë të moshuar të Kosovës për të diskutuar nevojat dhe shqetësimet e komunitetit jo-

shumicë, përfshirë për shembull, funksionalitetin e qendrës së kujdesit shëndetësor, kërkesat për ushqim falas për banorët e moshuar të komunitetit jo-shumicë, mungesa e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm dhe transportit publik, si dhe deponitë ilegale. KpK-ja përgatiti një raport dhe e paraqiti atë për veprim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, si dhe tek organizatat partnere ndërkombëtare. Bazuar në raportin e KpK-së, Kryetari i Komunës trajtoi disa çështje kryesore të ngritura nga komunitetet jo-shumicë. Për shembull, u nda një buxhet për të siguruar ushqim për banorët e moshuar të Letnicës, u funksionalizua edhe qendra shëndetësore e Vitisë, u instalua një sistem i ri i ujësjellësit, ndërsa fshati Letnicë u përfshi në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. KpK-ja ka vazhduar të organizojë vizita kontaktuese tek komunitetet jo-shumicë në komunë, si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar gjendjen lidhur me të drejtat dhe kushtet jetësore të tyre.

**KpK-ja e Graçanicës angazhohet në mënyrë proaktive me Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin në konsultime për të identifikuar dhe avokuar për nevojat e komunitetit.**

Në Graçanicë, pas një kërkesë për ndihmë nga një familje rome e Kosovës që ishte e zhvendosur e që jetonte në kushte të vështira banimi dhe financiare, KpK-ja bëri një vizitë kontaktuese te familja dhe vlerësoi sfidat dhe nevojat e tyre. Bazuar në gjetjet e tij, KpK përgatiti një kërkesë dhe ia paraqiti Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit për reagim urgjent, përkatësisht pagesën e qirasë në një vendbanim alternativ për familjen rome të zhvendosur të Kosovës. Përveç kësaj, pas angazhimit të KpK-së, komuna vendosi të njohë statusin e familjes si të kthyer, ndërsa Komisioni Komunal për Kthimin e futi atë në listën prioritare të rekomandimeve për Bordin Qendror Shqyrtues të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Si rezultat, u miratua edhe kërkesa e familjes për ndërtimin e shtëpisë.

## Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim

Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) janë të detyrueshme për të gjitha komunat dhe kanë mandat t'i mbrojnë të drejtat e komuniteteve, të sigurojnë qasje të barabartë në shërbime dhe të krijojnë kushte për kthim të qëndrueshëm. ZKKK-të i raportojnë drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, por duhet t'i raportojnë edhe KpK-së. Madhësia e ZKKK-ve dhe numri i pozitave përcaktohet varësisht nga përqindja dhe nevojat e komuniteteve që banojnë në komunë, si dhe numri i planifikuar apo i pritshëm i të kthyerve dhe personave të riatdhesuar.

Dokumentet kryesore ligjore dhe politikat për krijimin dhe funksionimin e ZKKK-ve janë:

- Rregullorja nr. 02/2010 për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim;
- Termat e Referencës për ZKKK-të - Procedurat Standarde të Veprimit.

## Praktikat e Zgjedhura

Funksionet substanciale	<b>Planifikimi dhe zhvillimi i projekteve, monitorimi dhe vlerësimi</b>
Baza ligjore	Rregullorja për ZKKK-të, Nenet 7, 8 dhe 9; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa II, pikat 3.3, 3.4 dhe 3.9
Praktikat e zgjedhura	<b>ZKKK-ja në Gjakovë harton dhe zbaton strategji 3-vjeçare dhe Plan Veprimi vjetor.</b>  Bazuar në vlerësimin e nevojave, të kryera me komunitetet jo-shumicë dhe të kthyerit, në bashkëpunim me komunitetet dhe organizatat joqeveritare lokale, ZKKK-ja ka hartuar një strategji 3-vjeçare dhe një plan veprimi vjetor. Këto dokumente shërbejnë si udhërrëfyes në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara, duke vendosur objektiva dhe standarde, si dhe duke i identifikuar prioritetet në baza vjetore dhe shumëvjeçare. Kjo praktikë rrit kapacitetin e ZKKK-së në kuptimin e planifikimit dhe zbatimit afatgjatë të ndërhyrjeve, si dhe siguron qëndrueshmëri për aktivitetet që zhvillohen.  <b>ZKKK-ja e Prishtinës vlerëson nevojat e fëmijëve nga familjet me të ardhura të ulëta, në bashkëpunim me shkollat dhe institucionet e tjera arsimore.</b>

	<p>Në Prishtinë, si pjesë e Planit Vjetor të Veprimit, ZKKK-ja ka kryer vizita kontaktuese si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme, duke vlerësuar nevojat e fëmijëve nga familjet me të ardhura të ulëta që i përkasin komuniteteve jo-shumicë. Si rezultat i kësaj, ZKKK-ja shpërndau pako higjienike dhe pajisje shkollore për 125 fëmijë që i përkisnin komunitetit ashkali të Kosovës dhe komunitetit rom të Kosovës. Me përkrahjen e shkollimit të nxënësve nga këto komunitete, ZKKK-ja po kontribuon edhe në zvogëlimin e braktisjes së shkollimit. Në këtë drejtim, pavarësisht nga kufizimet buxhetore, vlerësimi i nevojave dhe buxheti në dispozicion i mundëson ZKKK-së të shënjestrojë dhe adresojë nevojat e përfituesve më të cenueshëm. Për më tepër, bashkëpunimi midis ZKKK-së dhe KpK-së, si dhe organeve të tjera kryesore komunale, siguron që nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve të komunikohen dhe të merren parasysh në reagimin afatgjatë institucional, ashtu që qëndrueshmëria e ndërhyrjeve, edhe pse me natyrë ad-hok, të sigurohet.</p>
<p>Funksionet substanciale</p>	<p><b>Mbledhja e të dhënave dhe informatave në lidhje me komunitetet jo-shumicë, personat e zhvendosur dhe të kthyerit.</b></p>
<p>Baza ligjore</p>	<p>Rregullorja për ZKKK-të, Nenet 7, 8 dhe 9; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa II, pika 3;</p>
<p>Praktikat e Zgjedhura</p>	<p><b>ZKKK-ja e Klinës mbledh të dhëna dhe rregullisht mirëmban databazën me të dhëna e informata për komunitetet jo-shumicë.</b></p> <p>Në Klinë, ZKKK-ja ka mbledhur informata në lidhje me numrin dhe madhësinë e komuniteteve jo-shumicë që banojnë në komunë, si dhe ka krijuar një databazë të brendshme, ashtu që të identifikojë praninë e komuniteteve në komunë, si dhe të planifikojë aktivitetet dhe projekte. Kjo databazë mirëmbahet dhe të dhënat përditësohen rregullisht, gjë që e bën atë mjet të dobishëm jo vetëm për organet e ndryshme komunale në planifikimin e aktiviteteve dhe projekteve, por edhe për organizatat e tjera partnere vendore dhe ndërkombëtare. Sipas kërkesës, ZKKK-ja ka ndarë këto të dhëna me të gjitha palët përkatëse homologe.</p>

Funksionet substanciale	<b>Qasja në burime financiare</b>
Baza ligjore	Rregullorja për ZKKK-të, Neni 10.1; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa III, pika 3;
Praktikat e Zgjedhura	<p><b>ZKKK-ja në Klinë siguron që burimet financiare dhe logjistike të sigurohen për t’iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të komuniteteve jo-shumicë.</b></p> <p>Në Klinë, gjatë vizitave të rregullta kontaktuese në terren, ZKKK-ja pranoi disa kërkesa për ndihmë nga komunitetet jo-shumicë. Duke pasur parasysh mungesën e buxhetit të mjaftueshëm, ZKKK-ja avokoi tek Zyra e Kryetarit për të siguruar burimet financiare dhe logjistike, ose për të kërkuar nga drejtoritë përkatëse kompetente komunale që ta bëjnë këtë. Kur nuk u gjetën fonde në dispozicion në nivel lokal, ZKKK-ja avokoi tek institucionet e nivelit qendror, veçanërisht Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, për të siguruar ndihmën për komunitetet jo-shumicë. ZKKK-ja arriti të sigurojë burime financiare për adresimin e disa kërkesave nga komunitetet dhe të kthyerit, duke përfshirë, për shembull, burimet financiare dhe logjistike për rinovimin dhe ndërtimin e shtëpive të familjeve të cënueshme në zonat rurale, kompensimin për viktimat e incidenteve të sigurisë dhe shpërndarjen e pakove me ushqime dhe artikuj jo-ushqimorë për familjet në nevojë. Kjo mbështetje financiare dhe logjistike ka adresuar nevojat afatgjata dhe rritjen e sigurisë, rendit dhe mirëqenies së pjesëtarëve të komuniteteve.</p>

Funksionet substanciale	<b>Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me organet kryesore komunale për të adresuar nevojat dhe shqetësimet e komuniteteve</b>
Baza ligjore	Rregullorja nr. 02/2010, neni 4; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa II dhe III, pikat 2 dhe 3;
Praktikat e zgjedhura	<p><b>ZKKK-ja në Shtime mban komunikimin me komunitetet jo-shumicë dhe personat e zhvendosur, si dhe koordinon këmbimin e informatave dhe reagimin ndaj nevojave dhe shqetësimeve të komuniteteve.</b></p> <p>Në Shtime, komunitetet jo-shumicë kanë kërkuar shumë herë nga zyrtarët komunalë që të ndërmarrin veprime në lidhje me nevojën për mirëmbajtjen e varrezave të rrënuara ortodokse,. Megjithatë, nuk ishte ndërmarrë ndonjë veprim për të adresuar brengat e komuniteteve. Si reagim, ZKKK-ja mundësoi koordinimin e brendshëm me Zyrën e Kryetarit të Komunitetit dhe drejtoritë përkatëse komunale për të adresuar kërkesën. Në veçanti, Shefi i ZKKK-së siguroi që drejtoritë dhe kontraktorët komunalë të ngarkohen me detyrën e mirëmbajtjes së varrezave si dhe mundësimin e qasjes në to, për ç’gjë ZKKK-ja informoi me kohë pjesëtarët e komunitetit që kishin bërë kërkesën. Ndërhyrja e ZKKK-së siguroi që të drejtat dhe</p>



	<p>interesat e komuniteteve jo shumicë, sidomos të pjesëtarëve të tyre që janë të zhvendosur dhe herë pas here vizitojnë pronat e tyre dhe praktikojnë fenë e tyre, të mbrohen. Ajo po ashtu ka rregulluar edhe mangësitë në komunikim midis komunitetit në fjalë dhe institucioneve komunale, duke mundësuar që të mos e komprometojë më tutje angazhimin e komunitetit në jetën publike komunale.</p>
Funksionet substanciale	<b>Raportimi tek Komiteti për Komunitete dhe/ose organet tjera komunale</b>
Baza ligjore	Rregullorja nr. 02/2010, neni 8; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa II dhe III, pikat 2 dhe 3;
Praktikat e zgjedhura	<p><b>ZKKK-ja e Podujevës raporton rregullisht tek KpK-ja dhe ndan informatat për të mbështetur zgjidhjet e krijuara enkas për adresimin e nevojave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë.</b></p> <p>Në Podujevë, ZKKK-ja ka siguruar që informatat të ndahen rregullisht me KpK-në, përmes kanaleve zyrtare dhe joformale. Në veçanti, ZKKK-ja ka marrë pjesë rregullisht në takimet e KpK-së dhe ka raportuar në detaje për aktivitetet dhe informacionin e saj të mbledhur përmes takimeve me palët përkatëse dhe gjatë vizitave kontaktuese në terren tek komunitetet jo-shumicë. Raportet e ZKKK-së përfshihen në procesverbalin e mbledhjeve të KpK-së, gjë që përforcon transparencën dhe kujtesën institucionale. Përveç kësaj, ZKKK-ja përgatit raport vjetor me shkrim dhe raporte sipas nevojës, të cilat i dorëzohen Zyrës së Kryetarit të Komunës. Ndarja dhe raportimi i informatave lidhet me aktivitetet e planifikuara ose të zbatuara të ZKKK-së, informatat e mbledhura për nevojat e komuniteteve jo-shumicë gjatë vizitave kontaktuese në terren si dhe takimet me autoritetet komunale dhe të nivelit qendror, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Duke vepruar kështu, ZKKK-ja rrit në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e KpK-së për të ofruar rekomandime të përshtatura enkas për Kuvendin e Komunës, për adresimin e nevojave dhe sfidave të veçanta me të cilat ballafaqohen komunitetet jo-shumicë, siç është institucionalizimi i qendrave mësimore me bazë tek komuniteti, të cilat ofrojnë mbështetje arsimore për nxënësit ashkali dhe romë të Kosovës.</p>

Funksionet substanciale	<b>Partneriteti për zhvillimin e projekteve</b>
Baza ligjore	Rregullorja nr. 02/2010, neni 7.1.5; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa II dhe III, pikat 2 dhe 3;
Praktikat e zgjedhura	<p><b>ZKKK-ja në Istog bashkëpunon me institucionet qendrore dhe lokale, por edhe organizatat ndërkombëtare, në zbatimin e projekteve për komunitetet jo-shumicë.</b></p> <p>Në Istog, gjatë vizitave në terren tek komunitetet jo-shumicë dhe të kthyerit, ZKKK-ja pranoi kërkesa për ndihmë lidhur me, për shembull, mbështetjen për ndërtimin dhe rinovimin e shtëpive, si dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike. Me qëllim të adresimit të këtyre kërkesave, ZKKK ka shfrytëzuar partneritetin e saj të gjatë me organizatat ndërkombëtare dhe vendore, si dhe institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Disa projekte infrastrukturore, si asfaltimi i rrugëve, ndriçimi i rrugëve, mirëmbajtja e shtratit dhe brigjeve të lumit, u financuan përmes buxhetit komunal, falë bashkëpunimit optimal të ZKKK-së me Zyrën e Kryetarit të Komunës. Për më tepër, falë mbështetjes së ZKKK-së të siguruar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) si dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), u siguroa ndërtimi dhe mirëmbajtja e shtëpive për personat e zhvendosur (PZH), duke mundësuar procesin e kthimit dhe riintegrit të tyre. Për më tepër, bashkëpunimi midis ZKKK-së dhe Këshillit të Evropës, në kuadër të programit “RomaActed”, ishte jetik për financimin e projekteve të infrastrukturës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.</p> <p><b>ZKKK e Gjakovës siguron mbështetje nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare në zbatimin e projekteve në dobi të komuniteteve jo-shumicë.</b></p> <p>Në Gjakovë, bazuar në nevojat e komuniteteve jo-shumicë dhe të kthyerve, të cilat përfshinin ndërtimin e shtëpive, mirëmbajtjen e infrastrukturës, materialet shkollore dhe pako higjienike, ZKKK-ja është angazhuar në avokim afatgjatë me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë organizatat me bazë në komunitet, ambasadat dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare, për të adresuar këto nevoja. Në veçanti, si dhe si rezultat i përpjekjeve të saj, ZKKK-ja ka arritur të ndërtojë partneritet të fuqishëm me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK), gjë që çoi në përfshirjen e komunës së Gjakovës në projektin e financuar nga BE-ja "Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë", për ndërtimin e shtëpive të reja për familjet e kthyer. Përmes këtyre partneriteteve, janë kryer disa ndërhyrje të suksesshme, duke përfshirë 20 projekte për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e shtëpive, grante për krijimin e të ardhurave të dhëna për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe të kthyerit, si dhe shpërndarjen e materialeve shkollore, pakove ushqimore dhe higjienike.</p>

<p>Funksionet substanciale</p>	<p><b>Koordinimi dhe bashkëpunimi me komunitetet dhe palët komunale të interesit.</b></p>
<p>Baza ligjore</p>	<p>Rregullorja për ZKKK-të, nenet 4, 7, 8 dhe 9; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa II dhe III, pikat 2 dhe 3;</p>
<p>Praktikat e Zgjedhura</p>	<p><b>ZKKK-ja e Gjilanit mundësoi komunikimin midis Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe drejtorive tjera përkatëse komunale, si dhe komuniteteve jo shumicë, me qëllim të adresimit të nevojave dhe shqetësimeve.</b></p> <p>Në Gjilan, deponitë ilegale gjendeshin në një zonë të banuar kryesisht nga komuniteti rom i Kosovës, gjë që shkaktoi shqetësime për shëndetin dhe sigurinë e banorëve. Përfaqësuesit lokalë të komunitetit rom të Kosovës dorëzuan një kërkesë me shkrim të nënshkruar nga të gjithë banorët e zonës së prekur në ZKKK, duke kërkuar që deponitë ilegale të largohen dhe zona të pastrohet. ZKKK-ja i dha përparësi kërkesës dhe komunikoi me Zyrën e Kryetarit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për të ndërmarrë veprimet e duhura. Si rezultat, kjo e fundit kontraktoi shpejt një kompani të menaxhimit të mbeturinave për t'i larguar deponitë ilegale, si dhe për t'i grumbulluar rregullisht mbeturinat në zonë. Kjo ndërhyrje ka përmirësuar kushtet e jetesës në zonën e banuar me rreth 200 romë të Kosovës, si dhe ka bërë një zgjidhje të qëndrueshme përkitazi me çështjen e largimit të mbeturinave në vendbanim.</p> <p><b>ZKKK-ja e Rahovecit konsultohet me komunitetet jo shumicë përmes punëtorive me qëllim të përgatitjes së Planit lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.</b></p> <p>Në Rahovec, ZKKK-ja organizoi konsultime me përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë në formën e një raundi punëtorish, për përgatitjen e një Plani lokal Veprimi për zbatimin e Strategjisë për përfshirjen e romëve dhe ashkalive të Kosovës në shoqërinë e Kosovës 2017-2021. Për më tepër, ZKKK-ja u angazhua me drejtori të ndryshme komunale, shoqërinë civile dhe organizata ndërkombëtare, për konsultim dhe mbështetje. Për më tepër, ZKKK-ja ka zhvilluar disa takime me Kryesuesin e Kuvendit Komunal, me qëllim të përkrahjes në miratimin përfundimtar të PLV-së nga Kuvendi. Pas miratimit të PLV-së, Komuna ndau fonde të konsiderueshme për zbatimin e tij. Donatorët e jashtëm plotësuan shpenzimet komunale, duke ndarë më shumë se një të katërtën e buxhetit të përgjithshëm të PLV-së. Konsultimet e drejtpërdrejta të ZKKK-së me komunitetet kanë qenë jetike për vlerësimin e gjendjes së romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës në komunë, si dhe për hartimin e PLV-së të bazuar në nevoja dhe të orientuar drejt rezultateve.</p>

Funksionet substanciale	<b>Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve</b>
Baza ligjore	Rregullorja për ZKKK-të, Nenet 7, 8 dhe 9; Termat e Referencës të ZKKK-ve, Pjesa II, pika 3;
Praktikat e zgjedhura	<p><b>ZKKK-ja në Novobërdë zhvillon dhe zbaton Planin Komunal të Veprimit për dialog ndërmjet komuniteteve.</b></p> <p>Në Novobërdë, ZKKK-ja vazhdimisht ka prodhuar dhe zbatuar Planin Komunal të Veprimit (PKV) për dialog ndërmjet komuniteteve në bashkëpunim të ngushtë me mekanizmat e tjerë komunalë të pjesëmarrjes së komuniteteve. Në pajtim me PKV-në, mekanizmat e pjesëmarrjes së komuniteteve janë ngarkuar me detyrën e planifikimit dhe implementimit të nismave të avokimit dhe kontaktimit për të siguruar dialogun ndërmjet komuniteteve, si dhe konsultimet dhe përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në proceset vendimmarrëse në nivel komunal. Në veçanti, ZKKK ka organizuar një ngjarje të quajtur "Kafeneja e Atpëratyshme e Komuniteteve" për të nxitur dialogun ndërmjet komuniteteve. Ky organizim kishte të bënte me shijimin e versioneve të ndryshme të gjellëve tradicionale, të cilat janë të përbashkëta për kuzhinën e komuniteteve të ndryshme. Pjesëtarë nga të tre komunitetet që banojnë në komunë - shqiptarët, serbët dhe romët e Kosovës, morën pjesë në ngjarje, së bashku me përfaqësuesit komunalë, duke përfshirë Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës për Komunitete, si dhe zyrtarin komunal për barazi gjinore. Ngjarja promovoi me sukses dialogun mes komuniteteve në Novobërdë, dhe shërbeu si mundësi joformale që komunitetet të angazhohen drejtpërdrejt me zyrtarët komunalë.</p>

## Nënkryetari i Komunës për Komunitete

Nënkryetari i Komunës për Komunitete (NKKK) është një mekanizëm mbrojtës lokal i detyrueshëm në komunat ku komunitetet në një pakicë numerike përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Me vendim të Kuvendit Komunal (KK), mund të themelohet edhe në komunat ku popullsia e komuniteteve në pakicë numerike nuk e plotëson pragun prej dhjetë për qind. Kandidati për Nënkryetar të Komunës për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës nga komuniteti më i madh jo-shumicë në komunë, dhe miratohet nga KK-ja me shumicë të dyfishtë të votimit. NKKK-ja i përfaqëson të gjitha komunitetet që banojnë në komunë dhe është i mandatuar t'i japë këshilla dhe udhëzime Kryetarit të Komunës për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet, të avokojë në mënyrë proaktive për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe të mbështesë kërkesat e komuniteteve para organeve komunale.

Dokumentet kryesore ligjore dhe politike për themelimin dhe funksionimin e NKK-ve janë:

- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (nr. 03/L-040);
- Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 01/2014 për Procedurën e Emërimit të NKKK-ve në Komuna;<sup>1</sup>
- Termat e Referencës për NKKK-të (MAPL);

## Praktikat e Zgjedhura

Funksionet substanciale	<b>Këshillon dhe i jep udhëzime për çështjet e komuniteteve Kryetarit të Komunës</b>
Baza ligjore	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 61.4; Udhëzimi Administrativ nr. 02/2020, neni 7.1 dhe 7.2; Termat e Referencës për Zëvendës Kryetarin e Komunës për Komunitete, Neni 3;
Praktikat e zgjedhura	<b>NKKK-ja i Ferizajt e këshillon dhe bashkëpunon ngushtë me Kryetarin e Komunës për ngritjen e vetëdijes për parandalimin e braktisjes së shkollës nga pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë.</b>

<sup>1</sup> Në mënyrë të veçantë, Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 01/2014 është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2020, për procedurën e emërimit të Nënkryetarëve në komuna më 21 shtator 2020.

	<p>Në Ferizaj, shkalla e braktisjes së fëmijëve nga komunitetet rome, egjiptiane dhe ashkali të Kosovës është shkak për shqetësime serioze. Në këtë drejtim, NKKK-ja ka angazhuar Kryetarin e Komunës, KpK-në, ZKKKK-në, zyrtarët komunalë të arsimit, si dhe organizatat ndërkombëtare, në organizimin e një fushate vetëdijesimi në mesin e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës lidhur me braktisjen e shkollës. Për këtë qëllim, NKKK-ja, në bashkëpunim me ZKKKK, ka organizuar një tryezë diskutimi mes përfaqësuesve të komunës dhe prindërve dhe nxënësve nga të tri komunitetet, pas së cilës është zhvilluar një fushatë e përbashkët e vetëdijesimit derë më derë, që synonte arritjen tek prindërit dhe fëmijët e këtyre komuniteteve. Si rezultat, shumica e fëmijëve që kishin braktisur shkollën, janë kthyer në shkollë. Për më tepër, është forcuar bashkëpunimi mes komuniteteve jo-shumicë dhe strukturave komunale, dhe janë bërë intervenime shtesë për vetëdijesim për të siguruar që qasja në arsim të jetë e garantuar në mënyrë adekuate.</p>
<p>Funksionet substanciale</p>	<p><b>Konsultimi me Kryetarin e Komunës për intervenime financiare që i adresojnë nevojat dhe interesat e komuniteteve përmes buxhetit komunal</b></p>
<p>Baza ligjore</p>	<p>Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 61.4; Udhëzimi Administrativ nr. 02/2020, neni 7.3; Termat e Referencës për NKKK-të, neni 3;</p>
<p>Praktikat e zgjedhura</p>	<p><b>NKKK-ja i Kamenicës avokon për ofrimin e mbështetjes financiare për familjet e cenueshme serbe dhe rome të Kosovës.</b></p> <p>Në Kamenicë, NKKK-ja ka monitoruar dhe vlerësuar gjendjen socio-ekonomike dhe shëndetësore të familjeve të cenueshme të komuniteteve jo-shumicë me mbështetjen e zyrtarëve komunalë përmes vizitave të rregullta personale. Gjatë këtyre vizitave, pjesëtarët e komunitetit janë këshilluar se si t'i paraqesin në komunë kërkesat zyrtare për mbështetje financiare. Më pas, NKKK-ja ka avokuar te Zyra e Kryetarit të Komunës në favor të ofrimit të mbështetjes financiare për familjet e cenueshme që i përkasin komuniteteve jo shumicë, pjesëtarët e të cilëve janë të prekur nga sëmundjet kronike. Si rezultat, ndërhyrja e NKKK-së ka kontribuar në zbutjen e cenueshmërisë socio-ekonomike të familjeve të synuara të komuniteteve jo-shumicë dhe ka përmirësuar sado pak kushtet e jetesës së anëtarëve individualë të familjes me sëmundje kronike. Ai gjithashtu ka kontribuar në fuqizimin e pjesëtarëve të komuniteteve në lidhje me rrugët që duhet ndjekur për marrjen e mbështetjes financiare nga komuna.</p>

Funksionet substanciale	<b>Promovimi i dialogut ndëretnik</b>
Baza ligjore	Udhëzimi Administrativ nr. 02/2020, neni 7.4; Termat e Referencës për NKKK-të, neni 3;
Praktikat e zgjedhura	<p><b>NKKK-ja i Lipjanit shtrin kontaktin me komunitete pas një incidenti në një shkollë në një fshat me komunitete të përziera.</b></p> <p>Në Lipjan, pas akteve vandale ndaj një objekti shkollorë në fshatin me komunitete të përziera në Rubofc, NKKK-ja ka kontaktuar me përfaqësuesit e komuniteteve serbe dhe shqiptare të Kosovës në fshat dhe ka vizituar objektin e dëmtuar së bashku me KFOR-in. Gjatë takimit me komunitetet e prekura, NKKK-ja mori përsipër zëvendësimin e pronës së dëmtuar menjëherë. Krahas dënimit publik të incidenteve të sigurisë nga zyrtarët komunalë, kontaktimi me komunitetet e prekura është një komponent kryesor i reagimit ndaj incidenteve të tilla pasi ndihmon në bindjen e pjesëtarëve të komunitetit se të drejtat dhe interesat e tyre do të mbrohen dhe promovohen, me synimin e rikthimit të besimit publik dhe të kushteve për dialog ndëretnik.</p> <p><b>NKKK-ja i Kllkotit promovon dialogun ndërmjet komuniteteve duke organizuar një tryezë ndër-komunale me gratë nga komunitete të ndryshme.</b></p> <p>Në Kllkot, pjesëtarët e komunitetit shqiptar dhe komunitetit serb të Kosovës mbajnë poste të ndryshme publike, nga të cilët një numër i konsiderueshëm janë gra. Për më tepër, ishte vërejtur se zyrtarët komunalë nga komunitetet në pakicë numerike kishin kontakt të kufizuar me kolegët e tyre të komunave të tjera. Prandaj, NKKK-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët për parimet e barazisë gjinore dhe rolin e grave në qeverisjen lokale me zyrtare komunale gra nga komunitete të ndryshme nga komunat e Kllkotit dhe Kamenicës. Takimi ua mundësoi pjesëmarrëseve të ndajnë me njëra-tjetrën sfidat dhe arrijtjet lidhur me rolin e tyre në vendimmarrjen komunale, dhe promovoi dialogun ndëretnik nëpër komuna. Çështjet e diskutuara përfshinin stereotipet gjinore dhe vështirësitë në hartimin e buxheteve të përgjegjshme gjinore dhe në zbatimin e iniciativave që synojnë gratë. Si rezultat, pjesëmarrëset u pajtuan që të mbajnë lidhje të ngushta me njëra-tjetrën, të bashkëpunojnë më tej në nisma të ngjashme dhe të angazhojnë më tej publikun, veçanërisht gratë nga komunitetet e ndryshme dhe ato që jetojnë në zonat rurale.</p>

Funksionet substanciale	<b>Shtirirja e kontaktit me komunitetet jo shumicë dhe përcaktimi i prioriteteve të nevojave të komunitetit</b>
Baza ligjore	Termet e Referencës për NKK-të, neni 3
Praktikat e zgjedhura	<p><b>NKK-ja i Prizrenit organizon një vizitë kontaktuese në terren te pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në zonat rurale në mënyrë që të diskutojnë për nevojat dhe interesat e tyre.</b></p> <p>Në komunën e Prizrenit, ishte vërejtur se komunitetet jo-shumicë, veçanërisht boshnjakët dhe serbët e Kosovës që banojnë në zona rurale, nuk kishin njohuri të mjaftueshme për punën dhe përgjegjësitë e NKKK-së. Me iniciativën e NKKK-së, Komuna e Prizrenit organizoi një takim publik, duke ftuar aktivistë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, gazetarë, si dhe anëtarë të publikut nga komunitetet jo shumicë, përfshirë boshnjakët e Kosovës, turqit e Kosovës, serbët e Kosovës, romët e Kosovës, ashkalitë e Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës. Drejtorët komunalë, përfshirë ata të turizmit dhe zhvillimit ekonomik, ishin gjithashtu të pranishëm në takimin e kryesuar nga Kryetari i Komunës. Ngjarja shërbeu si një mundësi jo vetëm për të krijuar komunikim të drejtpërdrejtë me pjesëtarët e komuniteteve që banojnë në zonat rurale dhe për të mbledhur informata mbi nevojat dhe prioritetet e tyre, por edhe për të rritur vetëdijesimin mbi rolin dhe përgjegjësitë e NKKK-së. Çështjet kryesore të diskutuara gjatë kësaj ngjarje përfshinin (i) përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal; (ii) nevojat infrastrukturore të komuniteteve; dhe (iii) përfaqësimin e barabartë të komuniteteve në shërbimin civil komunal. Bazuar në gjetjet e takimit, disa projekte janë bashkë-financuar nga Komuna dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal, në mënyrë që të adresojnë nevojat e komuniteteve që banojnë në zonat rurale.</p>



## Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete

Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete (ZKKKK) është mekanizëm mbrojtës lokal i detyrueshëm në komunat ku komunitetet në pakicë numerike përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. Posti i ZKKKK-së mbahet nga kandidati i komunitetit jo-shumicë që merr më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për KK. ZKKKK ka në mandat shqyrtimin e ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre përmes akteve ose vendimeve të KK-së, dhe është përgjegjës për referimin e pretendimeve të tilla në KK për rishqyrtim. Në rrethana të veçanta, ZKKKK-ja mund t'ia paraqesë Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim aktet dhe vendimet e KK-së që konsiderohet se janë në shkelje të të drejtave të garantuara me kushtetutë.

Dokumentet kryesore ligjore dhe të politikave për krijimin dhe funksionimin e ZKKKK-ve janë:

- Kushtetuta e Kosovës, neni 62
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040
- Termat e Referencës për ZKKKK-të

## Praktikat e Zgjedhura

Funksionet substanciale	<b>Bashkëpunimi në shqyrtimin e politikave komunale që prekin interesat e komuniteteve</b>
Baza ligjore	Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 55.1; Termat e Referencës për ZKKKK-të, neni 2.1.4.1
Praktikat e zgjedhura	<b>ZKKKK-ja i Mitrovicës së Veriut, në bashkëpunim me akterët komunal dhe të jashtëm, avokon për krijimin e mekanizmave të pjesëmarrjes së komuniteteve në pajtueshmëri me ligjin.</b>  Në Mitrovicën e Veriut, ZKKKK-ja ka avokuar vazhdimisht për themelimin e ZKKK-së, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e komuniteteve dhe KK-në. Për më tepër, ZKKKK-ja e ka trajtuar këtë çështje edhe me institucionet e nivelit qendror, duke përfshirë MAPL-në dhe Ministrinë e Financave, si dhe me organizatat ndërkombëtare. Ky avokim afatgjatë ka rezultuar me miratimin e propozimit për themelimin dhe përbërjen e ZKKK-së nga KK-ja. Për më tepër, si pjesë e avokimit

	të tij, ZKXXX-ja është konsultuar me drejtuesit komunalë për të siguruar fonde të mjaftueshme për ZKXX-në në vitin e themelimit të saj të planifikuar.
Funksionet substanciale	<b>Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve</b>
Baza ligjore	Kushtetuta, neni 62.3; Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 55.1; Termat e Referencës për ZKXXX-të, neni 2.1.1.3 dhe 2.1.4.1
Praktikat e zgjedhura	<b>ZKXXX-ja i Kllkotit promovon dialogun ndëretnik duke e angazhuar rininë lokale në fushatë për pastrimin e mbeturinave.</b>  Me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe për të zvogëluar rrezikun e incidenteve të sigurisë, ZKXXX-ja në Kllkot ka organizuar një iniciativë për mbledhjen e mbeturinave, duke përfshirë më shumë se 50 nxënës të komuniteteve të ndryshme në pastrimin e hapësirave publike në fshatrat e me komunitete të përziera të Mogillës dhe Vërbovcit, duke përfshirë hapësirat e objekteve fetare dhe shkollave ndëretnike. Ky aktivitet, ku morën pjesë autoritetet lokale dhe udhëheqësit e komunitetit, ua ka mundësuar nxënësve pjesëmarrës të shprehin përkushtimin e tyre për të punuar së bashku në ruajtjen e mjedisit dhe për t'u përfshirë në dialog ndëretnik. Iniciativa ka inkurajuar akterë të tjerë në nivelin lokal që të propozojnë aktivitete të ngjashme, duke përfshirë një garë sportive, për të forcuar më tej marrëdhëniet mes të rinjve të komuniteteve të ndryshme.



# Opštinski mehanizmi za učešće zajednica

*Zbornik najboljih praksi*

Decembar 2021.

## Sadržaj

<b>Uvod</b> .....	51
<b>Metodologija</b> .....	51
<b>Odbori za zajednice</b> .....	52
Odabrane prakse.....	52
<b>Opštinske kancelarije za zajednice i povratak</b> .....	58
Odabrane prakse.....	58
<b>Zamenici predsednika opština za zajednice</b> .....	65
